



TERMAT E REFERENCES

Për angazhimin e një Agjencie për rekrutimin dhe menaxhimin e përfaqësuesve/stafit për fushatat (F2F)

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë tashmë ka vendosur me sukses një sistem për donacione të njehershme, duke u mundësuar donatorëve një mënyrë të lehtë dhe të sigurt për të kontribuar në misionin tonë. Në kuadër të zgjerimit të aktiviteteve të ngritjes së fondeve, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është duke filluar gjithashtu me implementimin e kanalit të ngritjes së fondeve përmes kontaktit të drejtëpërdrejtë (Face-to-Face), përmes të cilit përfaqësuesit tanë do të angazhohen drejtëpërdrejt me qytetarët për të promovuar mbështetjen e qëndrueshme mujore.

Për realizimin e këtij procesi SOS Fshatrat e Fëmijëve është në kërkim të një Agjencie bashkëpunëtoare e cila do të mbështesë organizatën përmes ofrimit të shërbimeve në procesin e rekrutimit, kontraktimit, menaxhimit administrativ dhe angazhimin e personave përgjegjës për ngritjen e fondeve në terren, me qëllim sigurimin e donacioneve të rregullta mujore nga donatorët individualë/qytetarë.

Ky aktivitet ka një rol të rëndësishëm në forcimin e vetëqëndrueshmërisë financiare të organizatës tonë dhe për mbështetjen e programeve për fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe ata në nevojë.

Fusha e punës

Fusha e punës përfshin ofrimin e shërbimeve të plota për rekrutimin, kontraktimin dhe menaxhimin administrativ të personave përgjegjës për ngritjen e fondeve përmes kontaktit të drejtëpërdrejtë (Face-to-Face). Agjencia e përzgjedhur do të ketë përgjegjësi për të siguruar dhe mirëmbajtur një ekip të qëndrueshëm të përfaqësuesve në terren (Facers), të cilët do të angazhohen në sigurimin e donacioneve të rregullta mujore nga qytetarët për SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë dhe promovimin e programeve të saj

Fusha e punës gjithashtu përfshin koordinimin e ngushtë me ekipin e SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë për planifikimin e aktiviteteve të terrenit, mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm mbi performancën e stafit dhe garantimin e cilësisë dhe konfidencialitetit gjatë gjithë procesit të zbatimit të kontratës.

Agjencia duhet të bashkëpunojë me ekipin e SOS për përfshirjen e kandidatëve në trajnimet hyrëse dhe për ndarjen e të dhënave të nevojshme për sistemet e brendshme të raportimit.

PËRGJEGJËSITË E AGJENCISË

- Mbështetje e plotë në procesin e rekrutimit të kandidatëve (përfshirë shpalljen e konkurseve, intervistimin dhe selektimin fillestar)
- Lidhjen e kontratave të punës nga agjenciai me kandidatët e përzgjedhur/punësuar.
- Menaxhimin e pagesave të të punësuarve (norma e pagesës e percaktuara nga SOS Fshatrat e Fëmijëve)
- Mirëmbajtjen e numrit të stafit të angazhuar në terren
- Agjencia është përgjegjëse për ekzekutim të pages , ndaljes së tatimit në burim dhe pageses së kontributit pensional të të punësuarve.
- Sigurojë minimum 3 kandidatë të rekrutuar dhe angazhuar gjatë muajit të parë të kontratës, në përputhje me kërkesat e SOS.
- Garanton mbajtjen e një numri minimal aktiv të stafit në terren gjatë gjithë periudhës së kontratës (1–5 persona, sipas nevojës).
- Paraqet raporte mujore administrative dhe financiare për personelin e angazhuar (përfshirë listën e stafit aktiv, pagesat e ekzekutuara, pagat, tatimit në burim , kontributin pensional, dhe raportet e zëvendësimeve).





- Siguron përputhshmëri të plotë me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe politikat e brendshme të SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

Shënim:

- Aktiviteti i ngritjes së fondeve do të zhvillohet në qytetin e Prishtinës dhe në afërsi të Prishtinës.
- Gjatë javës parashikohet që të punësuarit të punojnë 5 ditë, (përfshirë edhe fundjavat) nga 4 orë pune në ditë (20 orë/javë)

PROPOZIM-BUXHET

Oferta financiare duhet të përmbajë:

Oferta financiare e nënshkruar dhe vulosur / me logo, që duhet të përmbajë:

- Pagesë fikse mujore të Agjencisë për realizimin e aktiviteteve të propozuara.
- Çmimin për shërbim me 1–5 të punësuar;
- Çmimin për shërbim me 5–10 të punësuar;
- Çmimet të shprehura në euro (€) pa TVSH;

Tabelë e detajuar e çmimeve me ndarje e kostove sipas aktiviteteve (administratë, menaxhim, etj.).

Dokumentet që duhet të dorëzohen:

1. Certifikata e regjistrimit të biznesit;
2. Ofertë financiare e nënshkruar dhe e vulosur ose me logon e kompanisë (oferta financiare duhet të përfshijë buxhetin e ndarë sipas aktiviteteve dhe të jetë pa TVSH);
3. Planifikimi kohor për zbatimin e aktiviteteve;
4. Portofoli i kompanisë që tregon përvoja të ngjashme;
5. CV-të e ekipit që do të zbatojë aktivitetet;
6. Lista e klientëve të mëparshëm,
7. Së paku një referencë për punë të ngjashme të kryer gjatë tre viteve të fundit.
8. Metodologjinë/planin e punës (përfshirë qasjen në procesin e rekrutimit, mekanizmat e menaxhimit të kontratave për kandidatët e përzgjedhur, zëvendësimin e kandidatëve dhe raportimin administrativ), proceset e komunikimit dhe koordinimit me SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë si garancitë për cilësi dhe konfidencialitet.
9. Referenca / dokumente të tjera që dëshmojnë përvojën në punën me organizata të shoqërisë civile (OSHC).

Aplikimi:

Ofertuesit e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet dhe ofertën e mbyllur në pliko (zarf) (2 kopje) të nënshkruara nga përfaqësuesi ligjor dhe të shënuara: **“Ofertë për Agjenci për rekrutimin dhe menaxhimin e përfaqësuesve/stafit për fushtatat (F2F)”**.

Ofertat duhet të dorëzohen deri me datën: **05.01.2026** në zyret e SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, në adresën Velania “1 Tetori”, p.n. Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00.



KRITERET PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE

Nr	Kriteret	Pershkrimi	piket
1	Kapacitetet e kompanisë	Përvoja paraprake në shërbime të ngjashme (rekrutim, menaxhim kontratash, pagesa administrative) dhe kapaciteti i tyre për të përmbushur kërkesat e SOS Fshatrat e Fëmijëve	20
2	Metodologjia	Metodologjia e ofruar për rekrutim dhe menaxhim, respektivisht qasja, proceset dhe mekanizmat e propozuara për rekrutim, përzgjedhje fillestare dhe menaxhim të kontratave.	20
3	Referencat dhe klientët e mëparshëm	Lista e klientëve të mëparshëm, dhe një referencë për punë të ngjashme të kryer gjatë tre viteve të fundit	20
4	Oferta financiare	Konkurrueshmëria e çmimit sipas numrit të stafit (oferta të ndahet për 1-5 të punësuar, 5-10 të punësuar)	40

Kontrata do të lidhet për periudhën **15.01.2026–14.07.2026**, me mundësi vazhdimi në bazë të performancës dhe nevojave të projektit.

Politikat e SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë e ka dokumentin e politikave për mbrojtjen e fëmijëve dhe kodin e sjelljes, të cilat kontraktuesi pritët t'i përmbahet dhe nga ta do të kërkohej ta nënshkruajnë deklaratën e përkushtimit ndaj Politikave të SOS Fshatrave të Fëmijëve të cilat përfshijnë: Politikën për mbrojtjen e fëmijëve, Rregullorja për Parandalimin dhe mbrojtjen kundër ngacimit, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, Kodin e mirësjelljes, Deklarata për ruajtjen e të dhënave si dhe Rregullore kundër korrupsionit. Kjo do të bëhet me rastin e nënshkrimit të kontratës, ku kontraktuesi do të udhëzohet lidhur me proceset e brendshme të mbrojtjes së fëmijëve.

